Prerja e grafikut të funksionit linear (формула) me boshtin e abshisave  $x$  është pika e formës (формула). Kjo do të thotë se funksioni është i barabartë me zero, domethënë (формула) dhe (формула) fitohet si zgjidhje e të panjohurës  $x$  të barazimit linear (формула)

Fitojmë se pika me koordinata (формула) është prerja e grafikut të funksionit linear  $y = ax + b$  me abshisën  $x$ . Vlera e argumentit për të cilën funksioni është i barabartë me zero quhet zero e funksionit.


❖ Prerja e grafikut të funksionit linear  $y = ax + b$  me boshtin e ordinatave është pike e formës  $(0, y)$ . Kjo do të thotë se për  $x = 0$  fitohet (формула). Domethënë, pika me koordinata  $(0, b)$  është prerje e grafikut të funksionit linear  $y = ax + b$  me boshtin e ordinatave  $y$ .

1. Cakto prerjet me boshtet koordinative të funksioneve lineare:



Të gjendet zero e funksionit të çdonjërës prej funksioneve të dhëna lineare.

Shembulli 2. Në të njëjtin sistem koordinativ i vizatojmë grafikët e funksioneve lineare (формула). I fitojmë këta grafikë




o Shqyrtoji këto tri drejtëza dhe si është raporti i tyre reciprok?

Me siguri përfundove se të tri drejtëzat janë paralele. Kjo nuk është rastësisht, pasi kur koeficientët para argumentit janë të barabartë, atëherë grafikët e funksioneve lineare janë drejtëza paralele.

2 Cakto parametrin  $a$  për të cilin grafiku i funksionit linear (формула) është paralel me grafikun e funksionit (формула). Cilin funksion linear e fitove?

Shembulli 3. T'i vizatojmë në të njëjtin sistem koordinativ grafikët e funksioneve lineare (формула). I fitojmë këta grafikë




Me siguri përfundove se të tri drejtëzat priten në një pikë dhe atë në pikën  $(0, -1)$ .

Kjo nuk është rastësisht, pasi kur anëtarët e lire janë të barabartë, atëherë grafikët e funksioneve lineare priten në pikën  $(0, b)$  në boshtin e ordinatave  $y$ .

3. Cakto parametrin  $a$  për të cilin grafiku i funksionit linear  $y = (a - 3)x + a$  e pret boshtin e ordinatave në të njëjtën pikë me grafikun e funksionit  $y = -3x + 1$ . Cilin funksion linear e fitove?

Shembulli 4. T'i vizatojmë në të njëjtin sistem koordinativ grafikët e funksioneve



o Shqyrtoji grafikët e funksioneve lineare. Çfarë konstaton për grafikët e tyre?


Me siguri konstatove se të tri drejtëzat kalojnë nëpër fillimin e koordinatave  $O(0,0)$

Kjo nuk është rastësisht, pasi kur anëtarët e lire janë të barabartë me zero, atëherë grafikët e funksioneve lineare

kalojnë nëpër fillimin e koordinatave  $O(0,0)$ .

4. Cakto parametrin  $a$  për të cilin grafikët e funksionit linear (формула) kalojnë nëpër fillimin e koordinatave (формула). Cilin funksion linear e fitove?

Shembulli 5. T'i vizatojmë në të njëjtin sistem koordinativ grafikët e funksioneve  $y = -3$ ,  $y = 2$ ,  $y = 5$ ,  $y = -4$  :



- o Me siguri përfundove se të katër drejtëzat janë paralele me boshtin e abshisës  $x$ .

Kjo ndodh kur koeficienti para argumentit është zero d.m.th., për  $a = 0$  funksioni linear e ka formën  $y = b$ . Funksioni i këtillë quhet funksion konstant


- o 5. Cakto parametrin  $a$  për të cilin funksioni linear (формула) është funksion konstant. Cilin funksion linear e fitove?  
Mendo dhe përgjigju:

Le të jenë dhënë funksionet lineare (формула). Për funksionin linear (формула), vlen se (формула). Vërejmë se nëse rritet argumenti, rritet edhe vlera e funksionit linear (формула). Deri tani për funksionin linear (формула), vlen. Vërejmë se nëse rritet argumenti, vlera e funksionit linear bie.

Kjo nuk është rastësisht, pasi funksioni i dhënë linear (формула) a rritet ose bie, varet prej shenjës së koeficientit para argumentit

Prandaj a quhet edhe koeficienti i drejtimit.

6. T'i vizatojmë funksionet lineare (формула) (цртеж)



Prej grafikëve të funksioneve të dhëna lineare (формула) përfundohet se kur koeficienti i drejtimit është numër real pozitiv (формула), atëherë funksioni monotonisht rritet, por për koeficienti i drejtimit është numër negativ (формула) funksioni monotonisht bie.

6. Në të njëjtin sistem koordinativ vizatoji grafikët e këtyre funksioneve lineare: (формула). Cilët prej tyre kanë grafikë të cilët janë drejtëza paralele? Cilët grafikë priten në pikën e njëjtë të boshtit të ordinatave? Cilët grafikë rriten monotonisht, por cilët bien monotonisht?



Prerja e funksioneve lineare (формула) me boshtin e abshisës  $x$  quhet funksion zero

Grafikët e dy funksioneve lineare (формула) janë paralele, nëse koeficientët e tyre të drejtimit janë të barabartë ndërmjet veti d.m.th.,  $a =$

Grafikët e funksioneve lineare (формула) priten në të njëjtën pikë të boshtit të ordinatës, nëse kanë anëtarë të lire të njëjtë d.m.th.,  $b =$

Grafikët e funksioneve lineare (формула) kalojnë nëpër fillimin e koordinatave, nëse anëtari i tij i lire është 0 d.m.th.,  $b = 0$

Për monotoninë e funksionit linear (формула) mund të themi

- monotonisht rritet (формула) nëse d.m.th., për çfarëdo (формула)
- monotonisht zvogëlohet (формула) nëse d.m.th., për çfarëdo (формула)

Funksioni linear (формула) është funksion konstant nëse (формула)

Detyra për punë të pavarur:

1. Për funksionet lineare:

a) b) c)

cakto prerjet me boshtet e koordinatave!

2. Është dhënë funksioni linear  $y = (k + 1)x - 3$ . Cakto parametrin  $k$ , për të cilin:

a) funksioni linear ka zero  $x = 3$ ;

b) grafiku i funksionit linear është paralel me simetralen e kuadrantit të parë dhe të tretë;

c) funksioni linear rritet;

ç) funksioni linear zvogëlohet;

d) funksioni linear është funksionon konstant;

3. funksioni linear rrallë funksioni  $y = (2k + 1)x - 1$  për disa vlera të parametrin  $k$  kalon nëpër fillimin e koordinatave?

4. Për cilën vlerë të parametrin  $k$  grafikët e të dy funksioneve lineare  $y = (2k + 1)x - k$ ,  $y = 2x - e$  prejnë boshtin e ordinates në pikën e njëjtë?

5. Për cilën vlerë të parametrin  $k$  grafikët e të dy funksioneve lineare  $y = (2k + 1)x - k$ ,  $y = (2 - k)x - 1$  janë drejtëza paralele?

### 3. Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura

#### 3.1. Koncepti për barazim linear me dy të panjohura

Koncepti barazi, identitet dhe barazim tanimë janë të mësuara. Këtu përsëri kthehemi te barazimet.

- Barazimet (формула), janë barazime lineare me dy të panjohura  $x$  dhe  $y$
- Për barazimin linear me dy të panjohura (формула) zgjidhje te bashkësia e numrave natyrorë (формула) janë çifte të renditura  $(4,2)$ ,  $(6,5)$ ..., në bashkësinë e numrave të plotë (формула) janë çifte të renditura  $(4,2)$ ,  $(6,5)$ ,  $(0,-4)$ ,  $(-2,7)$   $\mathbb{Z}$
- Vërehet se barazimi linear me dy të panjohura ka pakufi shumë zgjidhje d.m.th., ai është i papërcaktuar.

#### 1. Të caktohen disa zgjidhje të barazimit linear me dy të panjohura (формула) në (формула)

Barazimi linear me dy të panjohura është barazim i llojit (формула) ku (формула) numrat (формула) quhen koeficient para të panjohurës, numri  $c$  është anëtar i lire, por (формула) dhe (формула) janë të panjohura të barazimit linear me dy të panjohura.

Për zgjidhjet e barazimit linear me dy të panjohura d.m.th., për formën normale të barazimit linear me dy të panjohura e saktë është:

Të zgjidhet barazimi linear me dy të panjohura domethënë të caktohet çifti i renditur i numrave realë të lejuar (формула) për të cilët barazimi  $ax + by = c$ , bëhet gjykim i vërtetë d.m.th., i saktë (формула).

Barazimi linear me dy të panjohura ka pakufi shumë zgjidhje d.m.th., ai është i papërcaktuar.

Vërejtje: Mënyrat për fitimin e barazimit ekuivalent me barazimin linear me dy të panjohura janë identike me mënyrat e dhëna për barazimin linear me një të panjohur te njësia modulare paraprake

Shembulli 1. Barazimi linear me dy të panjohura (формула) është ekuivalent me barazimi linear me dy të panjohura (формула). Barazimi i fundit linear me dy të panjohura është në formën normale (të përgjithshme)

2, Barazimi vijues linear me dy të panjohura (формула) mund të sillet në formën normale (të përgjithshme)

### 3.2. Koncepti për sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura

Shpeshherë te detyrat problemore kërkohen zgjidhjet e përbashkëta të dy barazimeve me dy të panjohura.

Bashkësia e dy barazimeve me dy të panjohura, për të cilat kërkohen zgjidhje të përbashkëta, quhet sistem prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura me formën (формула) (flasim për konjunksionin e dy barazimeve lineare me dy të panjohura), ku (формула). Numrat (формула) quhen koeficientët para të panjohurës, por numrat (формула) quhen anëtarë të lire të sistemit

### Shembulli 2

Kastrioti dhe Beni kanë shkuar së bashku në treg, Kastrioti ka blerë 2 kg mollë dhe 3 kg kumbulla dhe ka shpenzuar 190 denarë.

Beni ka blerë prej mollëve të njëjta 3 kg dhe prej kumbullat e njëjta 5 kg dhe ka shpenzuar 300 denarë. Sa denarë kushton 1 kg mollë, ndërsa sa 1 kg kumbulla?

$$2x + 3y = 190$$

Μένδο dhe πλργραφφ:

ο Γφιτημονλ σιστεμι πρεφ δψ βαραζιμεσε λινεαρε με δψ τλ πανφοηυρα α κα ζγφιδηφε τλ σετμε?

Πλρ ζγφιδηφεν ε σιστεμιτ πρεφ δψ βαραζιμεσε λινεαρε με δψ τλ πανφοηυρα λσητλ ε σακτλ κφο

Zgjidhje e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura është çdo çift i renditur (формула)

prej numrave realë të lejuar për të cilët të dy barazime te sistemi (формула) kalojnë në gjykime të vërteta d.m.th., (формула)

Sistemi mund të ketë zgjidhje të vetme (sistemi është përcaktuar), të mos ketë zgjidhje (sistemi është kundërthënës) ose të ketë pakufi shumë zgjidhje (sistemi është i papërcaktuar).

❖ Forma (формула) e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura quhet forma normale ose e përgjithshme e sistemit të barazimeve me dy të panjohura.

❖ Dy sisteme prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura janë ekuivalent në të njëjtën fushë të përkufizimit, nëse çdo zgjidhje e njërit sistem është zgjidhje edhe e sistemit tjetër.

❖ Sistemi ekuivalent me të dhënin fitohet kur cilido barazim të sistemit zëvendësohet me barazimin ekuivalent.

❖ Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura, nëse nuk është në formën e përgjithshme, atëherë me shfrytëzimin e të dhënit mund të sillet në formën normale (të përgjithshme).

Shembulli 3. Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) është në formën normale ose të përgjithshëm, por mund ta sjellim në këtë mënyrë:

$$\begin{cases} \frac{x-y}{2} = 3/2 \\ \frac{x+y}{3} = -2/3 \end{cases} \Leftrightarrow \begin{cases} x-y = 6 \\ x+y = -6 \end{cases}$$

3. Cilat prej këtyre çifteve të renditura është zgjidhje e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura

4. Këto sisteme prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura silli në formën normale: a) b)

Detyra për punë të pavarur:

1. Cakto disa çifte të numrave të plotë të cilët janë zgjidhje të sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura

2. Këtë barazim linear me dy të panjohura silli në formën normale (të përgjithshme)

3. Cili prej këtyre çifteve të renditura është zgjidhje e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohu

4. Këto sisteme të dy barazimeve lineare me dy të panjohura silli në formën normale (të përgjithshme):

$$\text{a) } \begin{cases} 3(x+y) - \frac{y}{7} = \frac{2}{5} \\ \frac{x-y}{2} + 3(x+y) = \frac{5}{7} \end{cases} ; \quad \text{b) } \begin{cases} 2\frac{x-y}{7} + \frac{x+y}{5} = \frac{1}{2} \\ \frac{x-2y}{5} - \frac{1}{7} = \frac{y}{2} \end{cases}.$$

## **4. Zgjidhja e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura: metoda e zëvendësimit dhe metoda e koeficientëve të kundërt**

### **4.1. Metoda e zëvendësimit**

Metoda e zëvendësimit për zgjidhjen e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura e shfrytëzojmë vetëm te sistemet të cilat janë në formën normale (të përgjithshme) (формула). Nëse nuk janë, së pari sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura duhet ta sjellim në formën normale (të përgjithshme) të sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura.

Sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura e zgjidhim me metodën e zëvendësimit ashtu që prej njërit barazim shprehet njëra prej të panjohurave, të cilën e zëvendësojmë te barazimi tjetër i sistemit duke fituar sistem ekuivalent me të dhënurit.

**Shembulli 1.** Sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) ta zgjidhim me metodën e zëvendësimit (формула)

Çifti i renditur (1,-2) është zgjidhje e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura.

1. Këto sisteme të barazimeve lineare me dy të panjohura zgjidhi me metodën e zëvendësimit: a) b)

### **4.2. Metoda e koeficientëve të kundërt**

Metodën e koeficientëve të kundërt ose metodën e barazimit për zgjidhjen e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura e shfrytëzojmë vetëm te sistemet të cilat janë në formën normale (të përgjithshme) (формула) Nëse nuk janë, së pari sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura duhet ta sjellim në formën normale (të përgjithshme) në sistem të barazimeve lineare me dy të panjohura.

prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura e zgjidhim me metodën e koeficientëve të kundërt ose me metodën e barazimit, kështu koeficientët para njërës të panjohur te dy barazimet duhet t'i transformojmë në numra të kundërt. Pastaj të dy barazimet i mbledhim. Fitojmë barazim linear me një të panjohur, të cilën e zgjidhim dhe zgjidhjen e fituar për atë të panjohur e zëvendësojmë te njëra prej barazimeve fillestare, për të fituar zgjidhjen e të panjohurës së dytë.

Shembulli 2. Sistemin e barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) ta zgjidhim me metodën e koeficientëve të kundërt ose me metodën e barazimit. Vërehet se koeficientët para të panjohurës janë numra të kundërt. I mbledhim të dy anët e barazimit dhe barazimi e fituar e shkruajmë si barazim të parë të sistemit, por për barazim të dytë e marrim cilado prej barazimeve fillestare. Kështu, fitojmë sistem që është ekuivalent me sistemin e dhënë (формула)

Çifti i renditur (формула) është zgjidhje e sistemit të dhënë prej dy barazimeve me dy të panjohura.

2. Këto sisteme të barazimeve lineare me dy të panjohura zgjidhi me metodën e koeficientëve të kundërt ose me metodën e barazimi: a) b)

Shembulli 3. Sistemi (формула) është sistem i barazimeve lineare me dy të panjohura. Ai zgjidhet me ndihmën e futjes së ndryshores ndihmëse (формула). Me ndryshoret e reja, i njëjti transformohet në dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула), që zgjidhet me ndonjërin prej metodave dhe fitohet zgjidhja (формула)

3. Zgjidhe sistemin (формула) me futjen e ndryshoreve ndihmëse

**Detyra për punë të pavarur:**

**1. Zgjidhi këto sisteme me njërën prej të dy metodave: a) b) c) ç**

**2. Zgjidhi këto sisteme me futjen e ndryshoreve ndihmëse a) b)**

**5. Zgjidhja e sistemit prej dy barazimeve me dy të panjohura. Metoda e Gausit**

### **5.1. Metoda e Gausit**

**Transformimet elementare të cilat zbatohen te sistemeve prej barazimeve lineare me dy të panjohura për fitimin e sistemeve ekuivalente janë:**

**a) zëvendësimi i vendeve të barazimeve;**

**b) shumëzimi i njërës prej barazimeve me numër i ndryshueshëm prej zeros dhe shtuarja e atij te barazimi tjetër.**

**Le të jetë dhënë sistemi i barazimeve lineare me dy të panjohura në formën normale: (формула)  
Metoda e Gausit për zgjidhjen e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura përbëhet prej eliminimit gradualisht të njërës prej të panjohurave te sistemi. Prandaj edhe kjo metodë është e njohur si metoda e eliminimit të Gausit. Prej sistemit fillestar me transformimet elementare fitohet sistem tek i cili te njëra prej barazimeve është eliminuar njëra prej të panjohurave. Sistemi i fituar është ekuivalent me sistemin fillestar.**

Shembulli 1. Për zgjidhje e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) do ta zbatojmë metodën e Gausit

a) barazimin e parë e shumëzojmë me -1 dhe e shtojmë te barazimi i dytë, (формула)  
E eliminojmë ndryshoren;

b) të dytën e pjesëtojmë me -3 dhe e fitojmë zgjidhjen për y (формула)

c) Zëvendësohet vlera e y te barazimi i parë dhe fitohet vlera e të panjohurës x, (формула)

Zgjidhja e barazimit është (1,1).

Jo patjetër të eliminohet e panjohura x, mund të eliminohet edhe e panjohura y, (формула)

Vërejtje: Nëse sistemi i dhënë i barazimeve lineare me dy të panjohura nuk është në formën normale, për ta zbatuar metodën e Gausit, është e nevojshme ta sjellim sistemin në formën normale.

1. Me metodën e Gausit zgjidhi këto sisteme të barazimeve lineare me dy të panjohura:

$$a) \begin{cases} x - y = 1 \\ x + 2y = 3 \end{cases};$$

$$б) \begin{cases} \frac{x}{5} - y = -1 \\ x + \frac{y}{2} = 6 \end{cases}.$$

## 5.2. Zgjidhja grafike e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura

E dimë se funksioni prej formës është funksion linear, grafiku i të cilit është drejtëz, ndërsa tani sistemi i barazimeve lineare me dy të panjohura në formën normale është

❖ Zgjidhja grafike e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura përbëhet prej të shprehurit të të panjohurës  $y$  si funksion e varur prej  $x$  të të dy barazimet dhe të vizatuarit e dy funksioneve lineare.


Vërejtje: Për ta zbatuar këtë metodë, është e nevojshme që sistemi i dhënë i barazimeve lineare me dy të panjohura të jetë në formën normale, në të kundërtën sistemin e dhënë e transformojmë në sistem ekuivalent prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura në formën normale.

Shembulli 2.

Grafikisht ta zgjidhim këtë sistem të barazimeve lineare me dy të panjohura (формула). Hapat për zgjidhjen janë:

a) Te sistemi edhe të dy barazimet e shprehim  $y$ ,

b) Në të njëjtin sistem koordinativ i vizatojmë dy funksionet lineare, (упрех)



c) Prerja e të dy drejtëzave është pika (1,1), e cila është zgjidhje e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura.

Me metodën grafike zgjidhja e sistemit të barazimeve lineare me dy të panjohura fitohet si prerje e të dy drejtëzave, të cilat janë grafikët e funksioneve të dhëna lineare, nëse sistemi ka zgjidhje të vetme.

❖ Nëse ka pafund shumë zgjidhje, atëherë grafikët do të jenë drejtëza të cilat puthiten. Sistemi nuk do të ketë zgjidhje nëse drejtëzat janë paralele

2. Me metodën grafike të zgjidhen këto sisteme prej dy barazimeve me dy të panjohura: a) b)

Detyra për punë të pavarur:

1. Me metodën e Gausit të zgjidhen këto sisteme prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura: a) b) c)

2. Me metodën grafike të zgjidhen këto sisteme prej dy barazimeve me dy të panjohura: a) b)



Prej sistemit të fundit vërehet se fitohen vlerat e këtyre determinantëve (формула

Ato do t'i shënojmë me (формула) Përfundojmë se sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura mund të zgjidhet me ndihmën e determinantëve.

Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) mund të zgjidhet me njehsimin e determinantës (формула).

Zgjidhjen e vetme e fitojmë me formulat (формула), të cilat quhen rregulla të Kramerit, ku (формула

## Shembulli 2

Ta zgjidhim sistemin prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула) me rregullat e Kramerit:

a) Vlera e determinantës (формула)

b) Zgjidhjet janë (формула)

c) Çifti i renditur (2,2) është zgjidhja e sistemit (формула)

2. Zgjidhi këto sisteme me ndihmën e rregullave të Kramerit: a) b)

### 6.3. Diskutimi për zgjidhjen e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura

E dimë se sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura mund të ketë zgjidhje të vetme (sistem i përcaktuar), pafund shumë zgjidhje (sistem i papërcaktuar) dhe të mos ketë zgjidhje (sistem kundërthënës).

Për sistemin prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула)

rregullat e Kramerit do t'i shënojmë në këtë formë (формула).

Tani mund ta diskutojmë zgjidhjen e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura

Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura ka zgjidhje të vetme (sistem të caktuar), (формула) nëse (формула) (sistemi ka zgjidhje të vetme, nëse raporti prej koeficientëve para njëres të panjohur nuk është e barabartë me raportin e koeficientëve para të panjohurës tjetër).

Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura ka pafund shumë zgjidhje (sistem i papërcaktuar) nëse

(формула) (raporti prej koeficientëve para njëres të panjohur është e barabartë me raportin e koeficientëve para të panjohurës së dytë) dhe:

a) Sistemi nuk ka zgjidhje (sistem kundërthënës) nëse të paktën njëra prej determinantëve (формула) është e ndryshueshme prej zeros d.m.th., (формула) d.m.th., (формула) (sistemi nuk ka zgjidhje nëse raporti prej koeficientëve para njëres të panjohur është e barabartë me raportin e koeficientëve para të panjohurës së dytë, por nuk janë të barabarta me raportin e anëtarëve të lirë).

b) Sistemim ka pafund shumë zgjidhje (sistem i pacaktuar) nëse dhe të dy determinantët (формула) janë zero d.m.th., (формула) d.m.th., (формула)

(sistemi ka pafund zgjidhje nëse raporti prej koeficientëve para njërës të panjohur është e barabartë me raportin e koeficientëve para të panjohurës së dytë, por nuk janë të barabarta me raportin e anëtarëve të lirë).

Shembulli 3. Ta diskutojmë zgjidhjen e këtij sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura (формула)

Determinantë janë: (формула)

- Sistemi ka zgjidhje të vetme (формула) për (формула) d.m.th., (формула)

- Sistemi ka pafund shumë zgjidhje ose nuk ka zgjidhje kur (формула) d.m.th., (формула)  
Për determinantët e sistemit janë, sistemi ka pafund shumë zgjidhje

Për  $a = 1$  determinantët të sistemit janë (формула), sistemi nuk ka zgjidhje

Diskutimi mund të jetë edhe pa njehsimin e determinantëve:

- Zgjidhje të vetme sistemi ka për (формула)

- Pafund shumë zgjidhje, nëse (формула)

- Nuk ka zgjidhje, nëse (формула)

3. Diskuto zgjidhjen e këtyre sistemeve a) b)

**Detyra për punë të pavarur:**

- 1. Njihso këto determinantë të rendit të dytë: a) b) c)**
- 2. Zgjidhi këto sisteme me ndihmën e rregullave të Krameri: a) b**
- 3. Diskuto zgjidhjen e këtyre sistemeve: a) b**
- 7. Zbatimi i sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura**

**Sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura zbatohet te detyrat prej jetës reale, detyra prej teknikës dhe detyra nga shkenca. Do të jepen disa shembuj.**

**Shembulli 1. Sot babai dhe djali së bashku kanë 65 vjet. Pas dy vjet babai do të jetë 2 herë më i vjetër se djali. Sa vjet ka babai, ndërsa sa djali në moment**

**Vitet e babait do t'i shënojmë me  $x$ , kurse vitet e djalit me  $y$ . Për ta parashtruar sistemin prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura do të na ndihmojë kjo skemë  
Skema në moment pas 2**

**(tani)**

**Babai  $x$     $x + 2$**

**Djali  $y$     $y + 2$**

**Në bazë të skemës dhe tekstit të detyrës mund të konstatojmë**

**1) Në moment babai dhe djali e kanë këtë barazim  $x + y = 65$**

**2) Pas 2 vjet barazimi e paraqet lidhjen ndërmjet babait dhe djalit është**

) E fitojmë sistemin

Sistemi zgjidhet me ndonjërin prej metodave paraprakisht të dhëna për zgjidhje dhe ai ka zgjidhje (44,21

Si përgjigje të kërkesës së detyrës kemi: në moment, babai ka 44 vjet, kurse djali 21 vjet

1. Shuma e viteve të gjyshit dhe nipit është 80 vjet. Para 5 viteve, gjyshi ka qenë 13 herë më i vjetër se gjyshit. Nga sa vjet ka çdonjëri prej tyre?

Shembulli 2. Dy motoçikletistë nisen njëri përballë tjetrit prej dy qyteteve A dhe B të larguar ndërmjet tyre 300 km. Motoçiklisti që niset prej qytetit A niset 1 orë më vonë prej motoçiklistit prej qytetit B dhe pas 2 orë ata takohen në gjysmë të rrugës. Nëse motoçiklisti që niset prej qytetit A e zvogëlon shpejtësinë për 15 km/orë, por tjetri e zmadhon shpejtësinë për 10 km/orë, atëherë ata nisen njëkohësisht dhe do të takohen në gjysmë të rrugës për 2,5 orë. Me çfarë shpejtësie vozit çdonjëri prej tyre?

Motoçiklisti që niset prej qytetit A e ka shpejtësinë  $x$  km/orë, kurse motoçiklisti që niset prej qytetit B ka shpejtësi prej  $y$  km/orë. Që të mund të formojmë sistem prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura e vizatojmë këtë vizatim (уравнения)

1 orë më vonë

$x$  km/orë  $y$  km/orë

Në momentin kur motoçiklisti niset prej qytetit A niset 1 orë më vonë prej motoçiklistit prej qytetit B dhe pas 2 orë ata takohen në gjysmë të rrugës, e fitojmë këtë barazim:  $2x + 3y = 100$ . Nëse motoçiklisti që niset prej qytetit A e zvogëlon shpejtësinë për 15km/orë, por tjetri e zmadhon shpejtësinë për 10km/orë ato do nisen njëkohësisht dhe do të takohen në gjysmë të rrugës për 2,5 orë fitohet barazimi:  $2.5(x-15) + 2.5(y + 15) = 300$ . E fitojmë sistemin, (формула) që ka zgjidhje (75,50). Fitojmë: në momentin, motoçiklisti prej qytetit A vozit me shpejtësi 75 km/orë, por motoçiklisti prej qytetit B vozit me shpejtësi 50 km/orë

2. Treni i udhëtarëve prej Shkupi niset në ora 7 në drejtim të Novi Sadit. Dy orë më vonë në të njëjtën kahe niset treni i shpejtë, që e arrin trenin e udhëtarëve në ora 12

. Treni i shpejtë prej Novi Sadi arrin në ora 18, kur treni i udhëtarëve është larguar 160 km nga Novi Sadi. Me çfarë shpejtësie lëvizin të dy trenat? Kur do të arrijë treni i udhëtarëve në Novi Sad?

Sa është largësia ndërmjet Shkupit dhe Novi Sadit?

Shembulli 3. Herësi i dy numrave natyrorë është 2 dhe mbetja 9. Nëse i pjesëtueshmi zmadhohet për 5 dhe pjesëtohet me pjesëtuesin e njëjtë fitohet pjesëltim pa mbetje me herës 3. Sa janë ata numra?

Të pjesëtueshmin le ta shënojmë me  $x$ , kurse pjesëtuesin me  $y$ . Barazimi i parë është: (формула).

Nëse i pjesëtueshmi zmadhohet për 5 dhe pjesëtohet me pjesëtuesin e njëjtë fitohet pjesëtim pa mbetje me herës 3, fitohet barazimi i dytë: (формула). E fitojmë sistemin (формула), që ka zgjidhje (формула). I pjesëtueshmi është 37, kurse pjesëtuesi është 14.

3. Ndryshimi i dy numrave është 75, por herësi i tyre është 4. Cilët janë ata numra?

Shembulli 4. Dy punëtorë Sajmiri dhe Halili mund ta kryejnë një punë për 12 ditë. Pas punës së përbashkët prej 5 ditësh njëri punëtor sëmuret, ashtu që tjetri, duke punuar vetë, e kryen punën për 17,5 ditë. Për sa ditë mund ta kryejë punën çdo punëtor, nëse punon vetë?

Sajmiri le ta kryejë vetë punën për  $x$  ditë, kurse Halili për  $y$  ditë. Sipas të dhënave të detyrës e formojmë sistemin:

Me zëvendësimin (формула) fitohet sistemi: (формула)

Me zgjidhjen e këtij sistemi fitohen zgjidhjet (формула).

Duke u kthye te zëvendësimi prapa fitohet se Sajmiri e kryen punën vet për (формула) ditë, por Halili për (формула) ditë.

4. Një rezervuar mbushet me dy gypa. Të dy gypat së bashku, rezervuarin e mbushin për 12 orë

Detyra për punët të pavarur:

1. Nëse numëruesin dhe emëruesin e një thyese i zmadhojmë për 2, atëherë fitohet thyesa (формула). Nëse numëruesi dhe emëruesi zbritet 2, atëherë fitohet thyesa (формула). Cila është thyesa?
2. Shuma e shifrave të një numri dyshifror është 15. Ndryshimi ndërmjet numrit dyshifror të shkruar me shifrat e njëjtë por në renditje të anasjelltë dhe numrit dyshifrorë të dhënë është 9. Për çfarë numër dyshifrorë bëhet fjalë?
3. Një fshatar ka ruajtur pula dhe dele. Së bashku kanë pasur 27 koka dhe 84 këmbë. Sa pula, ndërsa sa dele ka pasur fshatari
4. Herësi i dy numrave është 174, por mbetja 2. Ndryshimi prej të pjesëtueshmit i shumëzuar 2 dhe pjesëtuesi i shumëzuar me 250 është 298. Cilët janë ata numra?
5. Dy automobila janë nisur prej qytetit A nga qyteti B me shpejtësi prej 60 km/orë dhe 90 km/orë. Tri orë pas nisjes së automobilin të parë prej qytetit A niset automobila i dytë, atëherë njëkohësisht arrijnë në qytetin B. Pas sa orë ka vozitur çdonjëri prej të dy automobilave? Sa është largësia ndërmjet të dy qyteteve?
6. Sot ndryshimi ndërmjet viteve të nënës dhe vajzës është 28 vjet. Pas pesë vjet nëna do të jetë 5 herë më e vjetër se vajza. Nga sa vjet kanë nëna dhe vajza sot?
7. Një rezervuar mund të mbushet nëpërmjet 2 gypave. Nëse gypi i parë është i hapur 4 orë, i dyti 3 orë, mbushet me (формула) e rezervuarit. Nëse gypi i parë është hapur 2 orë, por i dyti 1 orë, atëherë rezervuari do të mbushet (формула) e rezervuarit. Për sa orë mund të mbushet rezervuari me çdo gyp në veçanti?
8. Nga Shtipi dhe Kavadari të larguar 60 km lëvizin dy biçikletist njëri kah tjetri. Biçikletisti i parë është nisur 10 minuta para të dytit. Pas 50 minuta prej nisjes së biçikletistit të dytë largësia e tyre ka qenë 6 km. Në 30 minutat vijuese prej tejkalimit kanë qenë të larguar 3,8 km. Me cilat shpejtësi kanë lëvizur biçikletistët?

## 8. Задачи за повторување на модуларната единица

1. Është dhënë funksioni linear  $y = (k - 1)x - (3 - k)$ . Cakto parametrin  $k$ , për të cilin:
- a) funksioni linear ka zero  $x = 1$ ;
  - b) grafiku i funksionit linear është paralel me simetralen e kuadrantit të dytë dhe të katërt;
  - c) funksioni linear rritet;
  - ç) funksioni linear zvogëlohet;
  - d) funksioni linear është funksion konstant.

2. Për cilën vlerë të parametrin  $k$  grafikët e të dy funksioneve lineare  $y = (3k - 1)x - (k - 3)$ ,  $y = 2x + k$  e prejnë boshtin e ordnatës në pikën e njëjtë?

3. Këto sisteme silli në formën normale: a) b)

4. Sistemin zgjidhe (формула) me metodën e zëvendësimit.

5. Sistemin zgjidhe me metodën e koeficientëve të kundërt.

6. Sistemin zgjidhe (формула) me metodën e Gausit.

7. Sistemin zgjidhe (формула) me metodën grafike.

8. Sistemin zgjidhe (формула) me rregullat e Kramerit.

9. Diskuto zgjidhjen varësisht prej parametrin  $k$  për sistemin (формула)

10. a) Shuma e shifrave të një numri dyshifror është 7.

Ndryshimi ndërmjet numrit dyshifror dhe numrit dyshifror të shkruar me të njëjtat shifra por në rendin e anasjelltë është 27. Cili është ai numër?

b) Në disponim kemi dy lloje të alkoolit 25% dhe 75%. Nga sa litra duhet të merret prej çdonjërit për të fituar 50 alkool prej 50%?



# 7

## FIGURAT GJEOMETRIKE NË RRAFSH



### QËLLIMET E NJËSISË MODULARE

Duke mësuar njësinë modulare, nxënësit duhet të aftësohen:

- ➤ të dallojnë konceptet e thjeshta dhe të nxjerra;
- ➤ t'i kuptojnë raportet ndërmjet pikave dhe drejtëzave në rrafsh;
- ➤ t'i përkufizojnë figurat e rrafshëta;
- ➤ të konstatojnë dhe të shfrytëzojnë veti të figurave të rrafshëta në problemet praktike.

## PËRMBAJTJA E NJËSISË MODULARE 7

257. Konceptet themelore dhe të

262. Raporti reciprok i pikës dhe drejtëzës. Raporti reciprok ndërmjet dy drejtëzave në rrafsh

267. Figurat gjeometrike në rrafsh: gjysmëdrejtëza dhe këndi

273. Figurat gjeometrike në rrafsh: segmenti dhe shumëkëndëshi

280. Figurat gjeometrike në rrafsh: vija rrethore dhe rrethi

285. Detyra për përsëritje të njësisë modulare

Gjeometria është degë e matematikës e cila llogaritet si shkencë për figurat. Ajo është njëra prej shkencave më të vjetra, e cila paraqitet në Egjiptin, Babilon dhe në Greqinë antike të lashtë, si nevojë për matje praktike të tokës, ku koncepti për matje, syprinë dhe vëllim janë të njohur qysh prej shekullit 6 p.e.r. Konstrukione gjeometrike kanë shfrytëzuar edhe indianët në shekullin 3 p.e.r. kur pavarësisht prej tyre, Euklidi ka dhënë formën aksiomatike dhe prandaj quhet gjeometria e Euklidit. Gjatë shekujve ajo është përsosur dhe përparimi i saj rezultoi me formën e saj të sotshme, si fushë e gjerë për shqyrtimin dhe punën e shkencëtarëve dhe praktikantëve.

## 1. Konceptet themelore dhe të nxjerra dhe gjykimet

### 1.1. Konceptet themelore dhe të nxjerra

Gjatë të mësuarit e gjeometrisë udhëhiqemi prej parimit: prej të njohurës nga e panjohura. Prandaj, futja e ndonjë koncepti të ri gjeometrik bëhet me shfrytëzimin tani më koncepteve të njohura gjeometrike. Qëndrimi i këtillë me të cilin futet koncepti i ri gjeometrik quhet përkufizim.

Përkufizimi është fjali nëpërmjet të cilës përcaktojmë ndonjë koncept me ndihmën tani më të koncepteve.

Në gjeometri dallojmë dy lloje të koncepteve gjeometrike: koncepte themelore dhe të nxjerra. Konceptet themelore janë koncepte prej të cilave fillon ndërtimi i gjeometrisë së Euklidit dhe ato futen pa përkufizim, por futja e tyre shpesh është me përshkrim të konceptit ose me shfrytëzimin e shembujve.

Koncepte të nxjerra janë ato koncepte të cilat përkufizohen dhe te përkufizimet e tyre shfrytëzohen konceptet themelore, por edhe konceptet e nxjerra të cilat paraprakisht janë përkufizuar.

Si koncepte themelore në rrafsh të cilat përvetësohen pa përkufizim janë: pika, drejtëza dhe largësia, por edhe koncepti rrafsh gjithashtu është koncept themelor, i cili nuk përkufizohet. Gjithashtu e dimë se:

- Pikat shënohen me shkronjat e mëdha latine (формула),...
- Drejtëzat shënohen me shkronjat e vogla latine (формула),...
- Rrafshet shënohen me shkronjat greke (формула),...
- Nëse A dhe B përcaktojnë pikë të njëjtë, atëherë shkruajmë (формула) (lexohet “puthitet me”).

Shembulli 1.

a) Segmentin si koncept të nxjerrë e përkufizojmë me këtë përkufizim: “Pjesë prej drejtëzës të kufizuar me dy pika, që i përmban ato dhe të gjitha pikat që shtrihen ndërmjet tyre”.

Vërejmë se për të përkufizuar koncept të nxjerrë “segment”, janë shfrytëzuar konceptet themelore pike dhe drejtëz.

b) Vija rrethore si koncept i nxjerr përkufizohet me këtë përkufizim: “Bashkësia e pikave të rrafshit të cilat gjenden në largësi të barabartë prej një pikë fikse O në rrafsh”.

Vërejmë se për të përkufizuar koncept të nxjerrë “vija rrethore” janë shfrytëzuar konceptet themelore bashkësi, pikë dhe largësi. Edhe koncepti bashkësi në matematikë është koncept themelor, që nuk përkufizohet.

Në vend të bashkësisë së pikave shpeshherë shfrytëzohet termi vend gjeometrik i pikave. Vijën rrethore dhe segmentin i llogarisim për figura rrafshore. Pikën dhe drejtëzën gjithashtu i llogarisim për figura rrafshore gjeometrike. Pikën dhe drejtëzën gjithashtu i llogarisim për figura në rrafsh.

❖ Koncepte themelore janë: pika, drejtëza, rrafshi dhe largësia.

❖ Çdo vend gjeometrik i pikave të rrafshit quhet figurë rrafshore gjeometrike ose shkurtimisht vetëm figurë.

❖ Koncepte themelore janë konceptet të cilat përkufizohen me shfrytëzimin e koncepteve themelore dhe koncepteve të nxjerra të cilat paraprakisht janë të përkufizuara.

Në përgjithësi çdo vend gjeometrik quhet figurë gjeometrike.

1. Përmend përkufizime të koncepteve të nxjerra: gjysmëdrejtëza, gjysmërrafshi dhe këndi.

## 1.2. Gjykimet themelore dhe të nxjerra

Vetitë dhe raportet e figurave gjeometrike janë shprehur me gjykime. Në gjeometri dallojmë dy lloje të gjykimeve: gjykime themelore dhe të nxjerra.

Gjykime themelore ashtu të quajtura aksioma janë gjykime të cilat i përvetësojmë pa vërtetim. Aksiomat zakonisht i shënojmë me  $A_1, A_2, A_3, \dots$

Aksiomat të cilat janë të nevojshme për ndërtimin e gjeometrisë janë aksiomat prej gjeometrisë së Euklidit. Ato janë:

Aksioma 1: Te çdo drejtëz shtrihen pafund shumë pika, por ekzistojnë edhe pika të cilat nuk shtrihen te drejtëza e njëjtë.

Aksioma 2: Çdo drejtëz është plotësisht e përcaktuar me dy pika.

Për dy pika A dhe B themi se janë ose të ndryshme (me shënim (формула)) ose puthiten (me shënim (формула), që do të thotë se bëhet fjalë për pikën e njëjtë me shënime të ndryshme

Përveç koncepteve pika dhe drejtëza në rrafshin gjeometrik shfrytëzohen edhe koncepti largësi, që tanimë është përmendur më lart. Largësinë ndërmjet dy pikave A dhe B e shënojmë me (формула).

Për këtë koncept themelore si pika i përvetësojmë këto aksioma:

Aksioma 3: Largësia prej pikës A deri te pika B është numër real pozitiv ose zero d.m.th., (формула). Nëse (формула), atëherë (формула). Nëse (формула), atëherë (формула)

Aksioma 4: Për çfarëdo dy pika A dhe B largësia prej A deri te B është e barabartë me largësinë prej B deri tek A d.m.th., (формула).

Aksioma 5: Për çfarëdo tri pika A,

B dhe C, largësia (формула) është më e vogël ose e barabartë me shumën e largësive (формула) dhe (формула) d.m.th..

2 Vizato vizatim që i përgjigjet (формула) dhe (формула) në pajtim me Aksiomën 5! (формула)

Koncepti largësi na mundëson të futim dhe përkufizojmë konceptin “shtrihet ndërmjet”:

Për një pikë C themi se shtrihet ndërmjet dy pikave A dhe B, nëse të tri pikat A, B dhe C janë të ndryshme dhe është e saktë (формула).

Është e saktë:

❖ Pikat që shtrihen në drejtëzën e njëjtë quhen pika kolineare.

❖ Pikat që shtrihen në rrafshin e njëjtë quhen pika komplanare.

Për konceptin “shtrihet ndërmjet” është e saktë kjo aksiomë:

Aksioma 6: Nëse një pikë shtrihet ndërmjet dy pikave të tjera, atëherë të tri pikat janë kolineare. Nëse A, B dhe C janë tri pika të ndryshme kolineare, atëherë pika A shtrihet ndërmjet pikave B dhe C ose pika B shtrihet ndërmjet pikave A dhe C ose pika C shtrihet ndërmjet pikave A dhe B.

Vërejtje: Aksiomat e Euklidit do t'i shfrytëzojmë edhe te njësitë e ardhshme mësimore.

Gjykimet e nxjerra të ashtuquajtura teorema, janë gjykime të cilat duhet të vërtetohen me shfrytëzimin e aksiomave ose gjykimeve të nxjerra (por paraprakisht të vërtetuara. Teoremat zakonisht i shënojmë me T1, T2, T3,...

❖ Aksiomat janë gjykime themelore të cilat i përvetësojmë pa vërtetim.

❖ Teoremat janë gjykime të nxjerra të cilat i përvetësojmë për të vërtetar pasi që i kemi vërtetuar me ndihmën e aksiomave ose tani me gjykime paraprakisht të vërtetuara

Shembulli 2. Shembull për teoremën.

Teorema: Te çdo drejtkëndësh diagonalet janë të barabarta ndërmjet veti.

Vërtetësia e teoremave vërtetohet. Çdo teoremë mund të shkruhet në formë të implikacionit (формула) d.m.th., në formën kushtore ku p është supozimi, kurse q është përfundimi. Te supozimi janë dhënë kushtet të cilat shfrytëzohen gjatë vërtetimit, por te përfundimi është dhënë ajo që duhet të vërtetohet

Shembulli 3. Teorema te Shembulli 2 është shprehur në formën kushtore:

Teorema: Nëse katërkëndëshi është drejtkëndësh, atëherë diagonalet e tij janë të barabarta.  
Supozimi p është: Katërkëndëshi është drejtkëndësh.

Përfundimi q është: Diagonalet e tij janë të barabarta.

Për teoremat (формула) të dhëna në formën kushtore ((формула)), mund ta shkruajmë edhe gjykimin e saj të anasjelltë (формула), e cila jo gjithmonë është teoremë. Nëse gjykimi i anasjelltë është teoremë atë e quajmë teorema e anasjelltë e të dhënës. Nëse janë teoremë edhe (формула) dhe (формула), atëherë të dy teoremat mund t'i shkruajmë së bashku me ekuivalencën d.m.th., në formën kushtore (формула)  
Mendo dhe përgjigju:

o Cili ligj logjik është shfrytëzuar?

Nëse nuk është e saktë njëri prej gjykimeve (формула) ose (формула), atëherë mund të fitojmë teoremën të shkruar në formën (формула).

Vërejtje: Teorema e shkruar si ekuivalencë (формула) vërtetohet edhe në të dy kahet d.m.th., vërtetohet teorema (формула), por edhe teorema (формула)

Shembulli 4. a) Teorema: Nëse një numër plotpjesëtohet me 15, atëherë ai numër plotpjesëtohet me 3 dhe 5.

Teorema është dhënë në formën (формула) dhe ne nuk mund ta formulojmë edhe gjykimin e anasjelltë (формула

“Nëse një numër plotpjesëtohet me 3 dhe 5, atëherë ai plotpjesëtohet me 15”.

Gjykimi i anasjelltë është i saktë (edhe vetë është teoremë) dhe paraqet teoremë të anasjelltë të teoremës së dhënë.

Prandaj të dy teoremat mund t'i shkruajmë me ekuivalencën:

Teorema: Një numër plotpjesëtohet me 15 nëse dhe vetëm nëse është i plotpjesitueshëm me 3 dhe 5.

b) Për teoremën vijuese të dhënë në formën (формула):

Teorema: Nëse dy numra janë çift, atëherë shuma e tyre është numër çift, ne mund ta formulojmë edhe gjykimin e anasjelltë (формула), “Nëse shuma e dy numrave është numër çift, atëherë ata numra janë çift”.

Gjykimi i anasjelltë nuk është i saktë d.m.th., nuk është teoremë.

Mendo dhe përgjigju:

o Pse?

3. Shpreh disa teorema sipas zgjedhjes tënde.

4. Për teoremën: nëse trekëndëshi është barakrahas, atëherë ai ka dy kënde të barabarta shprehe gjykimin e anasjelltë. Gjykimi a është teoremë? Nëse përgjigja është vërtetuar, atëherë të dy teoremat shprehi me ekuivalencë.

Përveç formës kushtore, teoremat mund të shprehen edhe në formën kategorike. Në formën e atillë është teorema prej Shembullit 1.

E mundshme është teorema prej kushtores të shprehet në formën kategorike dhe anasjelltas.

5. Kujtohu në teoremën në formën kushtore dhe të njëjtën shprehe në formën kategorike.

6. Kujtohu në teoremën në formën kategorike dhe të njëjtën shprehe në formën kushtore. Cakto supozimin dhe përfundimin e teoremës.



Për të paktën tri pika që i takojnë drejtëzës së njëjtë thuhet se janë pika kolineare. Nëse të paktën tri pika nuk i takojnë drejtëzës së njëjtë quhen pika jokolineare.

o Vizato pesë pika kolineare!

o Vizato pesë pika jokolineare!

Për raportin reciprok të pikës dhe drejtëzës do jepen këto aksioma, të cilat u përmendën te pjesa paraprake, si aksioma të gjeometrisë së Euklidi:

A1: Te çdo drejtëz shtrihen pafund shumë pika, por ekzistojnë edhe pika që nuk shtrihen në drejtëzën e njëjtë.

Te figura 1 është dhënë drejtëza  $a$  dhe tri pika A, B dhe C. Pikat A dhe B i takojnë drejtëzës  $a$  d.m.th., (формула), por pika C nuk i takon drejtëzës  $a$  d.m.th., (формула). Përveç pikave A dhe B, te drejtëza  $a$  ka pafund shumë pika. Kuptohet, përveç pikës C ekzistojnë edhe pika të tjera të cilat nuk i takojnë drejtëzës  $a$ .


Figura 1

A2: Çdo drejtëz është plotësisht përcaktuar me dy pika.

Kjo vërehet prej figurës paraprake, drejtëza  $a$  është plotësisht e përcaktuar me pikat A dhe B. Drejtëzën  $a$  mund ta shënojmë edhe me shenjën (формула) ose (формула). Këto teorema do t'i vërtetojmë:

Teorema 1: Nëpër një pikë kalojnë pafund shumë drejtëza.

Vërtetimi: Le të jetë dhënë drejtëza  $a$  dhe prej aksiomës A2 ajo është plotësisht e përcaktuar me dy pika



1. Duke e vërejtur figurën 3, përcakto vlerën e vërtetësisë së këtyre gjykimeve

Figura 3

2. Sa drejtëza mund të tërhiqen nëpër tri pika A, B dhe C? Përgjigja të sqarohet!

3. Në sa pika mund të priten tri drejtëza? Përgjigja të sqarohet!


2.2. Raporti reciprok i dy drejtëzave në rrafsh

o Të vizatohet rrafshi dhe të shënohet! Të vizatohet dy drejtëza në rrafsh.

Si mund të jetë pozita e tyre reciproke në rrafsh

Me siguri vëren se dy drejtëza a dhe b në rrafsh e kanë këtë pozitë reciproke:

Drejtëzat a dhe b nuk kanë pika të përbashkëta (формула) d.m.th., ato janë paralele si te figura 4:



Слика 4

Shkruajmë: (формула) lexohet “drejtëza  $a$  është paralele me drejtëzën  $b$ ”.  
Është e njohur edhe aksioma e Euklidi:

Aksioma 7: Nëpër pikën  $A$  që nuk shtrihet në drejtëzën  $a$  kalon vetëm drejtëza  $b$  e cila është paralele me drejtëzën  $a$ .

4. Për Aksiomën 7 bëj vizatim!

❖ Drejtëzat  $a$  dhe  $b$  kanë vetëm një pikë të përbashkët (формула) d.m.th., ato priten si te figura 5:

Figura 5

❖ Drejtëzat  $a$  dhe  $b$  kanë pafund shumë pika të përbashkëta d.m.th., ato puthiten si te figura 6:

Figura 6

Shkruajmë: (формула) lexohet “drejtëza  $a$  puthitet me drejtëzën  $b$ ”.

Mendo dhe përgjigju:

o Si është raporti reciprok i dy drejtëzave nëse kanë dy pika të përbashkëta?

Përgjigjen na jep kjo teoremë:

**Teorema 3:** Nëse dy drejtëza kanë dy pika të përbashkëta, atëherë të dy drejtëzat puthiten.

**Vërtetimi:** Nëse e shfrytëzojmë A2 se çdo drejtëz është plotësisht e përcaktuar me dy pika, atëherë qartë është se dy drejtëza kanë dy pika të përbashkëta, atëherë të gjitha pikat i kanë të përbashkëta. Domethënë, të dy drejtëzat puthiten d.m.th., të gjitha pikat prej njërës drejtëz i takojnë drejtëzës tjetër.

**Mendo dhe përgjigju:**

o Sa më së shumti pika të përbashkëta mund të kenë dy drejtëza të ndryshme?

Me siguri vëren në pajtim me atë që u tha paraprakisht se: dy drejtëza të ndryshme mund të kenë më së shumti një pikë të përbashkët.

Është e qartë se:

Dy drejtëza në rrafsh ose janë paralele ose priten ose puthiten.

5. Vizato një drejtëz a dhe pika (формула). Sa drejtëza nëpër pikën A mund të tërhiqen të cilat janë paralele me drejtëzën a? Vizato vizatimin!

6. Vizato një drejtëz a. Sa drejtëza mund të vizatohen paralele me drejtëzën a?

Bëj vizatim!

7. Vizato një drejtëz a dhe pika (формула). Sa drejtëza nëpër pikën A mund të tërhiqen të cilat priten me drejtëzën a? Sa prej tyre janë drejtëza normale në drejtëzën a? Bëje vizatimin!

**Detyra për punë të pavarur:**

1. Vërteto se ekzistojnë të paktën tri drejtëza të cilat kalojnë nëpër pikën e njëjtë.

2. Për çdo pike ekzistojnë drejtëza që kalojnë nëpër atë!

Për çdo pike ekzistojnë drejtëza që nuk kalojnë nëpër atë!

A janë të sakta?

3. Sa drejtëza mund të tërhiqen nëpër 5 pika të ndryshme? Përgjigja të sqarohet dhe të bëhet vizatim!

4. Në sa pika mund të priten 2 drejtëza? Shpjegoni përgjigjen dhe bëni një vizatim!

5. Sa rrafshe përcaktojnë 4 pika të cilat nuk janë kolineare? Përgjigja të sqarohet!



2. Vizato një drejtëz dhe në atë të shënohen tri pika. Sa gjysmëdrejtëza janë përcaktuar me ato tri pika?

3. Vizato tri pika të cilat nuk janë kolineare dhe të tërhiqen drejtëza nëpër çdo dy pika prej tyre. Sa gjysmëdrejtëza përcaktojnë ato?

### 3.2. Këndi

Vizato dy gjysmëdrejtëza  $a$  dhe  $b$  me pike të përbashkët  $O$ .  $a$  b  $O$   
Mendo dhe përgjigju:

o Te çdo gjysmëdrejtëz shëno nga një pikë  $A$  dhe  $B$ . Cila figurë gjeometrike fitohet? Emërtoji këndin.

o Si quhen gjysmëdrejtëzat  $OA$  dhe  $OB$ ? Si quhet pika  $O$ ?

### Figura 10

Këndi emërtohet si (формула) ose kënd , figura 10.

Figura e formuar prej dy gjysmëdrejtëzave me fillim të përbashkët, së bashku me pjesën e rrafshit të kufizuar me ato quhet kënd;

Pjesa e rrafshit të kufizuar me gjysmëdrejtëzat të një këndi quhet zonë e këndit dhe shënohet me hark rrethor. Gjysmëdrejtëzat  $OA$  dhe  $OB$  quhen krahët e këndit, pika  $O$  quhet kulmi i këndit

Në praktikë këndet shpesh maten në shkallë, por për matjen e këndeve ka edhe njësi matëse njësi radian.

Njësia matëse themelore për matjen e këndit është shkalla këndore d.m.th., 10 lexohet “një shkallë”.

Një kënd shkallor (10) është masa e këndit (формула), që është pjesë e këndit të drejtë. Njësi më të vogla janë minuta dhe sekonda d.m.th., (lexohet “një minutë”) dhe (lexohet “një sekondë”). Ndërmjet tyre vlejnë këto barazi  $10 = 60'$  dhe  $1' = 60''$ ;

Një rdian (1 rad) është masa e këndit, krahët e të cilit prej çfarëdo vije rrethore me qendër në kulmin e këndit pret hark gjatësia e të cilit është e barabartë me rrezen e vijës rrethore (figura 11).

Figura 11

❖ Këndi te figura 11 quhet kënd qendror.

Këndi me kulm në qendër të vijës rrethore quhet kënd qendror.

Në përgjithësi, nëse këndi qendror ka radian, atëherë gjatësia e harkut njehsohet me formulën (формула). Nëse këndi qendror është 3600, atëherë ai korrespondon me harkun (формула). Masa radiale për këndin (формула). Prej këtu fitojmë se: (формула).

